

Mbi 16 mijë nënshkrime
brenda 24 orëve për
peticionin e OVLUÇK-së
për liderët e luftës I PAGE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

PËRTEJ EMRAVE: ÇFARË PRESIDENTI I DUHET SOT KOSOVËS?



Vjosa Osmani presidente edhe një mandat?
Dikush që i shkon për shtati kryeministrit Albin
Kurti? Një figurë konsensuale? Të gjitha diskutimet
e mundshme po bëhen këto ditë në Kosovë se

kush duhet ta marrë pozitën e presidentit për pesë
vjetët e ardhshëm, por askush nuk flet përtej.
Çfarë figure i duhet sot Kosovës për president?
Çfarë vetish duhet t'i ketë?

**PSD-ja AKSION, MOLLIQAJ U
DËRGON 'KARTELË ANËTARËSIE TË
LV-SË, HAMZËS DHE ABDIXHIKUT'** F. 3



**AKADEMIK
ARSIM
BAJRAMI
PARAQITET
PËR POZITËN
E PRESIDENTIT**

F. 3

**RAPORTI I BERZH-IT: KOSOVA
NDËR VENDET MË TË GODITURA
NGA TARIFAT E REJA TË SHBA-së**

F. 8

**KOSOVA DHE MALTA
SHKËMBEJNË PËRVOJAT
PROFESIONALE
NË AUDITIMIN PUBLIK** F. 8

SPORT



**ADEMI URON INFANTINON PËR
10-VJETORIN NË KRYE TË FIFA-s** F. 11

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Delegacioni i PPE-së: Mbështesim rrugën e Shqipërisë drejt BE-së

TIRANË, 26 SHKURT - I udhëhequr nga sekretarja e përgjithshme e PPE-së, Dolors Montserrat, dhe nënkryetarja e PPE-së, Mairead McGuinness, tridhjetë përfaqësues të familjes së PPE-së vizituan Shqipërinë

dhe zhvilluan takime me Partinë Demokratike, diplomatë, ekspertë zgjedhorë, organizata joqeveritare dhe medie.

Në një shkrim të publikuar në rrjete sociale, PPE mbështet rrugën e Shqipërisë drejt

Bashkimit Evropian mbi bazën e meritës, por thekson nevojën për forcimin e pavarësisë së gjyqësorit, shtetit të së drejtës dhe lirisë së medias. “Të shqetësuar për dobësimin e demokracisë, delegacioni i PPE-së bën

thirrje për një opozitë të bashkuar dhe të fortë për të siguruar llogaridhënie, si dhe për reforma gjithëpërfshirëse zgjedhore dhe territoriale, që të garantojnë zgjedhje të lira dhe të ndershme”, thuhet në deklaratën publike.



AMERIKANËT TË SHQETËSUAR, SONDAZHET TREGOJNË ‘DYSHIME’ RRETH MPREHTËSISË MENDORE TË DONALD TRUMPTIT

UASHINGTON, 26 SHKURT - Presidenti Donald Trump fitoi garën presidenciale të vitit 2024 pasi kundërshtari i tij fillestar, presidenti i atëhershëm Joe Biden, u tërhoq për shkak të shqetësimeve në lidhje me moshën dhe ‘kthjelltësinë’ e tij mendore. Por, më shumë se një vit pas fillimit të mandatit katërvjeçar të Trumpit, shkruan CNN, sondazhet tregojnë se populli amerikan jo vetëm që është gjithnjë e më i pakënaqur me performancën e tij në punë, por është edhe gjithnjë e më i shqetësuar edhe për kapacitetin e tij mendor.

Shqetësimi nuk është në nivelet që ishte me Bidenin, i cili ishte 81 vjeç kur u tërhoq nga gara, por po rritet si një problem për Trumpin 79-vjeçar. Në fakt, sondazhe të shumta të



kohëve të fundit tregojnë se shumica e amerikanëve e vënë në dyshim atë në një mënyrë ose në një tjetër. Madje më shumë republikanët duket se kanë shqetësime.

Ndoshta sondazhi më mbresëlënës u bë të martën,

përpara fjalimit të parë të Trumpit për Gjendjen e Kombit gjatë mandatit të tij të dytë, i cili theu rekordin për fjalimin më të gjatë në Kongres.

Sondazhi i Reuters-Ipsos tregoi se 61 % e amerikanëve ishin dakord se Trumpi ka çrregullime

që lidhen me moshën. Edhe 30 % e republikanëve ishin dakord me këtë përgjigje.

Sondazhi u referohet disa sondazheve në mandatin e parë të Trumpit, kur shumë amerikanë filluan të vinin në dyshim mprehtësinë e tij mendore. Por, ndërsa përqindja e votuesve të regjistruar që thoshin se ai nuk ishte “mendërisht i qëndrueshëm” iu afrua 50 % në sondazhet e Universitetit Quinnipiac pas sulmit në Kapitolin e ShBA-së në vitin 2021, ajo kurrë nuk arriti në 61 %.

Sondazhi i Reuters-Ipsos tregoi gjithashtu një rënie në përqindjen e amerikanëve që thonë se Trumpi është “mendërisht i mprehtë dhe i aftë të përballot me sfidat”. Ky numër ka rënë nga 54 % në shtator 2023

në 45 % sot, transmeton “Top Chanel”.

Por Trumpi, i cili shpesh mburret për rezultatet e mira në testet njohëse dhe i cili foli për një orë e 47 minuta të martën në mbrëmje, nuk është ende as afër vendit ku ishte Bideni; vetëm rreth një e katërta e amerikanëve thanë se Bideni ishte mendërisht i mprehtë dhe i aftë t’i përballonte sfidat në korrik 2024, muajin kur ai hoqi dorë nga gara.

Sondazhe të tjera u bëjnë jehonë këtyre gjetjeve, përfshirë një nga CNN muajin e kaluar.

Ky sondazh tregoi se përqindja e atyre që thoshin se Trumpi ka “qëndresën dhe mprehtësinë për të shërbyer në mënyrë efektive si president” ka rënë nga 53 % në fund të vitit 2023 në 46 % sot.

RUSIA E SULMON UKRAINËN NË PRAG TË BISEDIMEVE SHBA - UKRAINË NË GJENEVË

KIEV, 26 SHKURT - Forcat ruse i kanë sulmuar disa rajone të Ukrainës me dronë dhe raketa në prag të bisedimeve të planifikuara mes ekipeve ukrainase dhe amerikane në Gjenevë të Zvicrës më 26 shkurt. “Dhjetëra persona janë plagosur si rezultat i këtij sulmi, përfshirë edhe fëmijë”, shkroi në rrjetet sociale presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky, disa orë para nisjes së bisedimeve. Ndërtesa banimi u përfshinë nga zjarri si pasojë e sulmeve, sipas videoeve të shpërndara nga shërbimet e emergjencës. Zelensky tha se Rusia lëshoi 420 dronë dhe 39 raketa, duke goditur gjithashtu infrastrukturën e gazit dhe nënstacionet e rrymës. Sulmet gjatë natës ndodhën disa orë para takimeve në Gjenevë, të cilat pritet të përqendrohen në një “paketë prosperiteti” të projektuar për rimëkëmbjen ekonomike të Ukrainës, sipas zyrtarëve ukrainas dhe amerikanë. Këto bisedime shihen edhe si bazament i mundshëm për një

samit të mundshëm trepalësh me Rusinë, sipas tyre. Sekretari i Këshillit Kombëtar të Sigurisë dhe Mbrojtjes së Ukrainës, Rustem Umerov, pritet të takohet me të dërguarin e posaçëm amerikan Steve Witkoff dhe Jared Kushnerin, dhëndri i presidentit amerikan Donald Trump.

Para bisedimeve, sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio, i cili nuk po merr pjesë, tha se vetëm Uashingtoni mund t’i udhëheqë negociatat për t’i dhënë fund luftës. “Kombet e Bashkuara nuk do ta bëjnë. Franca nuk do ta bëjë. BE-ja nuk do ta bëjë. Rusët as që do të flasin me ta. Prandaj ne nuk duam të tërhiqemi, e dimë që, në fund, lufta në Ukrainë nuk zgjidhet ushtarakisht”, tha ai. “Nëse ne heqim dorë nga ky rol, askush tjetër nuk mund ta bëjë”, shtoi ai.

Trumpi dhe Zelensky zhvilluan një bisedë telefonike më 25 shkurt. Në një postim në rrjetet sociale pas telefonatës, Zelensky theksoi se të dërguarit e Trumpit morën pjesë në diskutim, i cili u



përqendrua kryesisht në agjendën e raundeve të ardhshme diplomatike. “Ne presim që ky takim të krijojë një mundësi për t’i çuar bisedimet në nivelin e liderëve”, shkroi Zelensky, duke shtuar se Trumpi “e mbështet këtë sekuencë hapash”. Ai e përshkroi një samit të drejtpërdrejtë mes liderëve si “e vetmja mënyrë për të zgjidhur të gjitha çështjet komplekse dhe të ndjeshme dhe për t’i dhënë përfundimisht fund luftës”.

Takimi në Gjenevë po mbahet dy ditë pasi në mbarë Ukrainën u mbajtën ceremonitë për kujtimore për ta shënuar përvjetorin e katërt të pushtimit të plotë nga Rusia dhe pason bisedimet trepalëshe Rusi - Ukrainë - ShBA më 17 dhe 18 shkurt.

Pak informacione thelbësore kanë dalë nga takimet e mëparshme, përtej përshkrimeve të paqarta se ato kanë qenë “të vështira” në disa fusha, ndërsa kanë arritur

“përparim” në të tjera. Pas katër vjetëve lufte të plotë, vlerësimet për numrin e përgjithshëm të viktimave ndryshojnë. Megjithatë, një raport i fundit e vendos numrin e të vrarëve, të plagosurve dhe të zhdukurve në 1.2 milion rusë dhe 500 000 - 600 000 ukrainas. Banka Botërore tha më 23 shkurt se rindërtimi i ekonomisë ukrainase do të kushtonte rreth 588 miliardë dollarë gjatë një dekade.

AKADEMIK ARSIM BAJRAMI PARAQITET PËR POZITËN E PRESIDENTIT

Akademiku Arsim Bajrami u është drejtuar me një thirrje publike liderëve të partive politike për unitet politik për zgjedhjen e presidentit të vendit, duke shprehur gatishmërinë për të garantuar për president të Kosovës. Ai ka theksuar se i plotëson kushtet e një kandidati konsensual, në një kohë kur vendi duhet të nxitohet për ta zgjedhur presidentin e ri

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 26 SHKURT - Akademiku Arsim Bajrami u ka bërë thirrje për unitet politik liderëve të partive politike për zgjedhjen e presidentit të vendit. Ai në një thirrje publike, drejtuar kryetarit të Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës, Bedri Hamza, kryetarit të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku dhe kryetarit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se në këtë çast të rëndësishëm për stabilitetin institucional dhe funksionimin kushtetues të Republikës së Kosovës, përtej dallimeve politike dhe interesave partiake, të ndërtohet një unitet politik konsensual për zgjedhjen e presidentit të Republikës së Kosovës, me qëllim të shmangies së krizave të panevojshme institucionale, rrezikut të shpërndarjes së Kuvendit dhe mbajtjes së

zgjedhjeve të parakohshme. Bajrami ka thënë se në këtë kohë shpreh gatishmërinë për të vënë veten në dispozicion të institucioneve dhe të spektrit politik dhe të qytetarëve të vendit si një prej kandidatëve konsensual për president të Republikës së Kosovës, siç ka thënë ai, me përkushtim të plotë ndaj unitetit kombëtar, forcimit të rendit kushtetues, stabilitetit institucional dhe përmbylljes të procesit të shtetndërtimit, në shërbim të qytetarëve dhe të perspektivës evropiane të Republikës së Kosovës. “Duke pasur parasysh sfidat komplekse gjeopolitike dhe të sigurisë me të cilat përballlet Republika e Kosovës, të cilat kërkojnë maturi shtetërore, unitet politik dhe përgjegjësi të lartë institucionale; Duke marrë në konsideratë nevojën imperative për përmbylljen e qëndrueshme të procesit të shtetndërtimit, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, parimin e sovranitetit shtetëror dhe orientimin euroatlantik të

vendit; Duke çmuar rolin kushtetues të Presidentit të Republikës si figurë unifikuese, mbi-partiake dhe përfaqësuese e unitetit politik dhe qytetar të popullit të Kosovës; Duke u bazuar në përvojën time shumëvjeçare në të gjitha fazat kyçe të shtetndërtimit të Kosovës që nga viti 1990, përfshirë rezistencën institucionale, ndërtimin e rendit kushtetues dhe proceset vendimtare të tranzicionit politik; Duke qenë njëri ndër hartuesit e të gjitha akteve themelore kushtetuese të Kosovës, si dhe duke dhënë kontributin tim politik, juridik dhe institucional gjatë luftës çlirimtare të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në funksion të realizimit të së drejtës së popullit të Kosovës për liri, vetëvendosje dhe shtet të pavarur; Duke pasur përvojë të drejtpërdrejtë në negociatat ndërkombëtare për lirinë e Kosovës në Rambuje dhe për pavarësinë e saj në procesin e bisedimeve të Vjenës; Duke njohur në mënyrë të thelluar



sistemin kushtetues, juridik dhe institucional të Republikës së Kosovës, si dhe mekanizmat e funksionimit të institucioneve në plan vendor dhe ndërkombëtar; Duke ndërtuar ndër vite bashkëpunim institucional korrekt, dialog politik konstruktiv dhe respekt reciprok me të gjitha subjektet politike; Me bindje se i plotësoj kushtet profesionale, politike dhe morale për një kandidaturë konsensuale në funksion të unitetit politik dhe funksionimit kushtetues të institucioneve të Republikës së Kosovës, shpreh gatishmërinë time për të vënë veten në dispozicion të institucioneve

dhe të spektrit politik dhe të qytetarëve të vendit si njëri prej kandidatëve konsensual për president të Republikës së Kosovës, me përkushtim të plotë ndaj unitetit kombëtar, forcimit të rendit kushtetues, stabilitetit institucional dhe përmbylljes të procesit të shtetndërtimit, në shërbim të qytetarëve dhe të perspektivës evropiane të Republikës së Kosovës”, ka thënë Bajrami. Ai ka vlerësuar qëndrimin dinjitoz, parimor dhe shtetformues të kolegut dhe mikut të tij të fakultetit, prof. dr. Murat Jashari dhe të familjes Jashari, të cilët, në frymën e përgjegjësisë kombëtare dhe respektit për sakrificën historike të familjes heroike, dëshmuar edhe njëherë vigjilencën e lartë kombëtare. “Ju shpreh gatishmërinë time për angazhim të vazhdueshëm institucional, akademik dhe publik në mbrojtje të karakterit çlirimtar dhe të drejtë të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, si dhe, kundër çdo përpjekjeje për demonizimin e saj apo për rishikimin selektiv e diskriminues të historisë nga Dhomat e Specializuara, në kundërshtim me parimet themelore të drejtësisë dhe të së vërtetës historike”, ka shkruar në letrën publike Arsim Bajrami.

MBI 16 MIJË NËNSHKRIME BRENDË 24 ORËVE PËR PETICIONIN E OVLUÇK-së PËR LIDERËT E LUFTËS

PRISHTINË, 26 SHKURT - Mbi 16 mijë nënshkrime janë mbledhur në petitionin i cili është hapur para 24 orëve nga Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së për ish-krerët e saj që po mbahen në Hagë nga Gjykata Speciale.

Aktualisht janë 16 005 persona që kanë nënshkruar petitionin, përmes të cilit kërkohet që vendimi i cili pritet të merret, duhet të bazohet ekskluzivisht në prova dhe fakte të administruara në gjykim. “Çdo ndikim i drejtpërdrejtë apo i tërthortë politik do ta dëmtonte rëndë kredibilitetin e drejtësisë ndërkombëtare, e cila presim të jetë e paanshme dhe pa standarde të dyfishta”, thuhet në petition.

Pesë pikat e kërkesës së këtij peticioni janë:

1. Respektim të plotë dhe të pakushtëzuar të të drejtave themelore të të akuzuarve, respektim të Ligjit për Dhomat e Specializuara të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, si dhe respektim të plotë të Kushtetutës së Republikës së



Kosovës; që garantojnë proces të drejtë, transparent dhe të paanshëm, në përputhje me standardet më të larta të drejtësisë.

2. Trajtim dinjitoz dhe njerëzor, në përputhje me konventat ndërkombëtare për të drejtat e të paraburgosurve, duke garantuar

respekt të plotë për integritetin fizik dhe psikologjik të tyre; përfshirë këtu edhe heqjen e menjëhershme të masës së paraburgimit, duke marrë parasysh kohëzgjatjen e jashtëzakonshme të procesit dhe parimin e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm.

3. Vlerësim rigoroz, profesional dhe plotësisht të paanshëm të provave, në përputhje me standardet ndërkombëtare të pranueshmërisë, duke përjashtuar çdo provë që nuk përmbush kriteret e besueshmërisë, autenticitetit dhe ligjshmërisë procedurale.

4. Përjashtim të menjëhershëm dhe të plotë të çdo prove të siguruar apo të pranuar nga autoritetet e Serbisë, duke pasur parasysh se Serbia asokohe ishte palë në luftë dhe është dokumentuar ndërkombëtarisht përfshirja e forcave të saj në krime dhe masakra të kryera në Kosovë. Pranimi i provave të prodhuara nga ta, paraqet rrezik serioz për integritetin e procesit dhe bie ndesh me parimin e paanshmërisë dhe barazisë.

5. Eliminim të aplikimit të zgjeruar të konceptit të “përgjegjësisë komanduese”, pasi që në kontekstin e luftës në Kosovë, Ushtria Çlirimtare e Kosovës është paraqitur si organizim i armatosur i lindur nga rrethanat e vetëmbrojtjes së popullsisë dhe jo si ushtri shtetërore me zinxhir formal dhe të institucionalizuar komandimi. Parimi i përgjegjësisë penale në të drejtën ndërkombëtare është individual dhe nuk mund të zgjerohet në mënyrë kolektive apo abstrakte pa prova konkrete të kontrollit efektiv dhe urdhërdhënies së drejtpërdrejtë.



PËRTEJ EMRAVE: ÇFARË PRESIDENTI I DUHET SOT KOSOVËS?

Vjosa Osmani presidente edhe një mandat? Dikush që i shkon për shtati kryeministrit Albin Kurti? Një figurë konsensuale? Të gjitha diskutimet e mundshme po bëhen këto ditë në Kosovë se kush duhet ta marrë pozitën e presidentit për pesë vjetët e ardhshëm, por askush nuk flet përtej. Çfarë figure i duhet sot Kosovës për president? Çfarë vetish duhet t'i ketë?

PRISHTINË, 26 SHKURT - Individit që e ka mbajtur pozitën e presidentit të Kosovës jo rrallëherë është konsideruar fytyra e vendit jashtë kufijve. Përveç rolit në politikë të jashtme, përgjegjësitë dhe obligimet e personit në këtë pozitë janë shumë të qarta. Mes të tjerash, presidenti i Kosovës garanton respektimin e Kushtetutës nga institucionet e tjera, është komandant i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), ka rol në drejtësi në emërimet e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, si dhe emëron shefin e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë (AKI).

Një tjetër obligim shumë i rëndësishëm: presidenti duhet të jetë simbol i unitetit në skenën politike. Visar Ymeri, drejtues i Institutit "Musine Kokalari", beson se presidentja aktuale, Vjosa Osmani, e cila e synon edhe një mandat, nuk e ka kaluar testin në këtë drejtim. Ymeri thotë për Radion Evropa e Lirë se Osmani nuk ka qenë figurë uniteti më 2025, në vitin e krizës institucionale në Kosovë, dhe ka anuar nga Lëvizja Vetëvendosje (LV) e kryeministrit Albin Kurti disa herë, përfshirë shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme

parlamentare më 28 dhjetor - siç kishte kërkuar kjo parti. Edhe partitë opozitare e kanë kritikuar me raste presidenten për njëanshmëri. Por, në anën tjetër, Osmani është lavdëruar për përforsim të lidhjeve me Perëndimin, sidomos me Shtetet e Bashkuara të Amerikës - aleaten më të rëndësishme të vendit. Osmanit i skadon mandati pesëvjeçar më 4 prill, ndërsa Kuvendi i Kosovës ka afat deri më 4 mars që ta votojë emrin e presidentit për mandatin e ri. Pse LV-ja nuk po e propozon Osmanin?

Vjosa Osmani u bë presidente më 2021, me propozim të LV-së. Për propozimin e një kandidati në Kuvend nevojiten 30 nënshkrime deputetësh, ndërsa LV-ja, e vetme, i ka 57 sosh. Për zgjedhjen e kandidatit nevojiten të paktën 80 vota në njërin nga dy raundet e para, ose 61 në të tretin. Sipas Ymerit, ekzistojnë dy arsye kryesore pse LV-ja nuk dëshiron ta propozojë Osmanin për presidente: 1. Ajo nuk ka përtuar ta zëvendësojë Kurtin në marrëdhëniet me ShBA-në, kur zyrtarët amerikanë nuk kanë dashur të flasin me Kurtin. Rrjedhimisht, nuk ia garanton nivelin e besnikërisë që e kërkon kryeministri. 2. Mandati i dytë nënkupton mandatin e fundit të mundshëm për Osmanin, dhe kështu ajo mund të jetë edhe më e pavarur në marrjen e vendimeve. Edhe Toby Vogel, analist në

Këshillin për Demokratizimin e Politikave në Bruksel, thotë për Radion Evropa e Lirë se zyrtarët e huaj e konsiderojnë Osmanin më pragmatike në krahasim me Kurtin, "i cili nuk duket shumë i gatshëm për kompromise". Osmani, përmend ai, ka marrëdhënie të ngushta me amerikanët, të cilat Kurti nuk i ka. "Ajo e ka shfrytëzuar këtë në maksimum. Ajo është parë në fotografi me [presidentin amerikan, Donald] Trumpin të paktën dy herë, dhe disa herë tjera me Sekretarin amerikan të Shtetit, Marco Rubio. Nuk ka shumë politikanë ashtu në gjithë botën. Mund të ketë diskutime të gjata se pse është ashtu, lobimet, prapavija dhe të gjitha këto, mirëpo simbolikisht kjo është goxha e fuqishme". Duke mos dashur që t'ia nënvlerësojë arritjet, Ymeri rikujton që Osmani nuk është udhëheqësja e vetme e shtetit

PSD-ja AKSION, MOLLIQAJ U DËRGON ‘KARTELË ANËTARËSIE TË LV-së, HAMZËS DHE ABDIXHIKUT’

PRISHTINË, 26 SHKURT - Kryetari i Partisë Socialdemokrate (PSD), Dardan Molliqaj, ka zhvilluar të enjten një aksion simbolik para selisë së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), duke thënë se i ka dërguar “kartelën e anëtarësisë” kryetarit të PDK-së, Bedri Hamza. Ai ka thënë se kjo parti nga zhvillimet e fundit të kryetarit Hamza është shndërruar në degë të LV-së. “Qysh po e shihni, në mënyrë simbolike ia kemi pru kartelën e anëtarësisë kryetarit të PDK-së, Bedri Hamzës. Ajo çka ka ndodhur pas procesit zgjedhor të 28 nëntorit është që një opozitë që do të duhej të ishte formale bile në Kuvendin e Kosovës, është shndërruar në degë të Vetëvendosjes”, ka thënë Molliqaj. Sipas tij, për një vit partitë opozitare nuk janë takuar as me kryeministrin Albin Kurti dhe as mes vete për të diskutuar formimin e qeverisë. “Pas një viti, nën pretekstin që Kosovës nuk i duhen më zgjedhje, tash po thonë se mund t’ia votojnë presidentin që e propozon LV-ja. Po ku keni qenë deri tash? Pse na çuat dy herë vitin e kaluar në zgjedhje? Pse nuk u



bëtë bashkë PDK-LDK e AAK, e as me Albinin kurrë njëri?”, u shpreh ai. Molliqaj kritikoi edhe qëndrimet e mëhershme lidhur me pozitën e kryetarit të Kuvendit, duke përmendur emrin e Albulena Haxhiut. “Qysh është e mundshme që s’bën Albulena Haxhiu me qenë kryetare e Kuvendit, që i

takon edhe me Kushtetutë herën e kaluar, po bën me ia zgjedh presidentin që do Albini?”, tha ai. Sipas kreut të PSD-së, zhvillimet e fundit po i shërbejnë “koncentrimit të pushtetit absolut” të Kurti dhe interesave të ngushta partiake. Ai përmendi si shqetësim kapjen e mundshme të pozitës



së kryeprokurorit të shtetit dhe zgjedhjen e shtatë nga nëntë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. “Nuk është problemi i emrave. Problemi është që kjo e koncentron pushtetin tek Albin Kurti dhe ai i ka dy synime: kapjen e kryeprokurorit të shtetit dhe zgjedhjen e shtatë gjyqtarëve

nga 9 që i ka Gjykata Kushtetuese, dy aktualisht e pesë e përfundojnë mandatin në muajin gusht”, tha Molliqaj. Molliqaj aksion të njëjtë simbolik zhvilloi edhe para selisë së Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), duke shtuar se zhvillimet e fundit politike tregojnë për një rrezik serioz ndaj demokracisë në vend.

të Kosovës që ka pasur raporte të mira me partnerët, sidomos me ShBA-në. “Të njëjtat i ka pasur edhe [Hashim] Thaçi, edhe [Ibrahim] Rugova, edhe [Fatmir] Sejdiu, të mos flasim për Atifete Jahjagën, e cila po ashtu e ka pasur një pritje të jashtëzakonshme në ShBA. Kjo tregon që, në fakt, nuk është presidenti ai që po e përcakton këtë marrëdhënie, por është Kosova dhe interesi i Kosovës”.

Uniteti i brendshëm apo përfaqësimi i jashtëm?

Ymeri beson se mund të gjendet një person që mund t’i bëjë të dyja, prandaj partitë opozitare duhet ta bëjnë të pamundurën që zëri i tyre të dëgjohet në këtë proces. Megjithatë, ai ka vërejtur se nuk ekziston “një matricë kriteresh dhe tiparesh të cilën po e përdorin partitë politike për ta diskutuar emrin konsensual”, pasi diskutimet janë më tepër në rrafshin e taktikave politike. Për Ymerin, përmendja e familjes Jashari ditëve të fundit është bërë për arsye simbolike, dhe është përdorur sakrificë e familjes dhe respekti që kanë

qytetarët për të. “Kur po vendoset theksi te familja Jashari dhe te sakrificë, po e shmangin këtë diskutim të nevojshëm se çfarë presidenti i duhet Kosovës, sepse respekti ndaj familjes dhe sakrificës së familjes po e mbulon këtë diskutim të rëndësishëm politik”.

Shoqëria civile u bënë thirrje partive për ujd rreth presidentit për t’i shmangur zgjedhjet e parakohshme

Dhjetë organizata të shoqërisë civile në Kosovë u kanë bërë thirrje përmes një letre partive parlamentare ta vendosin interesin qytetar para atij partiak dhe të arrijnë marrëveshje për zgjedhjen e presidentit të ri të vendit, në mënyrë që t’i shmangin një palë zgjedhjesh të tjera parlamentare. Në letërën e tyre, organizatat e shoqërisë civile u kërkuan partive të “angazhohen me seriozitet dhe përgjegjësi në dialog konstruktiv ndërpartiak; të vendosin interesin qytetar mbi kalkulimet partiake; të

kontribuojnë në arritjen e një marrëveshjeje që siguron funksionimin e plotë institucional”. Shoqëria civile thotë se, duke i parë zhvillimet rreth votimit për president, “ka rrezik real që vendi të përballët sërish me zgjedhje të parakohshme për shkak të mungesës së marrëveshjes politike”. “Duke pasur parasysh se vendi ka kaluar tashmë një periudhë të zgjatur pa stabilitet të plotë institucional, çdo vonesë e mëtejshme në konstituimin e plotë të institucioneve cenon funksionimin demokratik të institucioneve, zhvillimin ekonomik dhe besimin qytetar në sistemin politik”, thuhet në letërën e saj.

Jasharët mohojnë përfshirjen në garën për president

Anëtarë të familjes së heroit të Kosovës, Adem Jashari, e kanë mohuar se kanë ndonjë qëllim për të garuar për president të vendit, pasi ministri i Jashtëm, Glauk Konjufca, tha të mërkurën se, nëse do të vinte një emër për president nga kjo familje, do të ishte një

“konsensus automatik” në shoqëri. Por, Murat Jashari, djali i Rifat Jasharit, vëllait të Adem Jasharit, tha për VOX Kosova se nuk ka interesim apo qëllim për t’u bërë president i Kosovës, dhe se “ua kam bërë të qartë partive politike se cilat janë arsyet pse unë nuk e bëj, sepse mbi supet e mia rëndon një barrë e madhe”. Më vonë, Bekim Jashari, ish-kryetari i komunës së Skenderajt, i tha Radios Evropa e Lirë se ai mban qëndrimin e djalit të xhaxhait, duke shtuar “nuk kam çka t’i shtoj kësaj, asnjë pikë apo presje”.

Tahiri: PDK-ja e gatshme të nxjerrë emër për president

Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, Arian Tahiri, tha se subjekti i tij është i gatshëm të nxjerrë emër për president, nëse i kërkohet, por theksoi se nuk mbështet asnjë kandidat “të njëanshëm”. Gjatë një prononcimi për medie të enjten, Tahiri tha se PDK-ja, subjekti më i madh opozitar që ka 22 deputetë,

voton për një kandidat për president, që sipas tij, ka reputacion e integritet vendor e ndërkombëtar, që ka kontribute intelektuale dhe “që i bën nder Kosovës dhe qytetarëve”. Megjithatë, Tahiri tha se ende nuk është diskutuar për emra të përveçëm për president, duke shtuar se nëse nuk gjendet një zgjidhje, PDK është e gatshme për zgjedhje të parakohshme. Tahiri tha se në takimet e kreut të partisë së tij, Bedri Hamza, me atë të Lëvizjen Vetëvendosje, Albin Kurti, nuk është diskutuar për ndonjë marrëveshje politike dhe partia e tij nuk është e interesuar për diçka të tillë, por mbështet një kandidat për president që plotëson kërkesat e tyre. “Nuk dua të lëshohem në emra të përveçëm, por mendoj që vendit nuk i bën nder një emër që ka pas qasje të njëanshme dje, dikush që përfaqëson vetëm një grup apo subjekt, por po flasim për dikë që është mbi partitë politike. Në këtë nivel jemi duke folur në parime dhe standarde, por nëse është e nevojshme dhe e arsyeshme dhe kërkohet, padyshim që PDK-ja do të nxjerrë edhe emër”, tha ai.

NGA 'FACEBOOK'-U TE FRUTHI: SKEPTICIZMI QË NDIKON NË VAKSINIMIN E FËMIJËVE NË KOSOVË DHE RAJON

PRISHTINË, 26 SHKURT - A i keni vaksinuar fëmijët? Pse, ose pse jo? Kjo pyetje, e shtruar nga Radio Evropa e Lirë në një grup për nënat në "Faceboook", nxiti 23 përgjigje dhe disa replika. Me dyshime mbi përbërjen e vaksinave dhe efektin e tyre, disa nëna treguan se nuk i kanë dërguar fëmijët për t'i marrë vaksinat.

Ligji për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve Ngjitëse në Kosovë kërkon që çdo fëmijë që regjistrohet në çerdhe apo shkollë, të pajiset me dëshmi të vaksinimit. Por, komentet e disa nënave sugjerojnë se ky kriter nuk po respektohet plotësisht. "Fëmija nuk e ndjek shkollën, është ende në kopsht. Fëmijës tjetër, më i madh, që e përfundon tani shkollën, nuk i janë kërkuar [dëshmitë e vaksinave]. Përkundrazi, kur është dashur t'i marrë në shkollë, nuk e kam dërguar atë ditë", komentoi një nënë, e cila tha se fëmijët e saj nuk kanë marrë asnjë vaksinë.

REL-i e parashtroi këtë pyetje nxitur nga një raport i Komisionit Evropian, që evidentonte përhapjen e bindjeve konspirative në Kosovë, përfshirë besimin se kura për kancerin mbahet e fshehur për përfitime financiare dhe se viruset prodhohen qëllimisht për kontroll të shoqërisë.

Mbi 60 për qind e banorëve të Kosovës pajtohen me këto dy besime, sipas raportit të publikuar në shkurt të vitit të kaluar nga Komisioni Evropian. Ai raport, i bazuar në intervista të bëra sy-më-sy me respondentë nga vendet evropiane, tregon se niveli i lartë i skepticizmit mbetet i ngjashëm në pothuajse të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Raporti shpërfaqti edhe besimin në rënie në Kosovë për efektin e vaksinave.

Në Kosovë, vakcina e parë kundër Covid-19 - që sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë i ka shpëtuar mbi 1.4 milion jetë në Evropë - është dhënë më 29 mars të vitit 2021. Që atëherë, janë administruar mbi 1.8 milion doza.

Por, pikërisht sëmundja Covid-19, e shkaktuar nga një koronavirus, ka ndikuar që të rriten dyshimet për efektin e



vaksinave, thonë nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK) për Radion Evropa e Lirë. "Pandemia e Covid-19 e përforcoi këtë skepticizëm, sidomos për shkak të shpejtësisë së zhvillimit të vaksinave dhe debatit të madh publik rreth masave kufizuese", thonë nga IKSHPK-ja.

Paul Offit, pediatër dhe ekspert i vaksinave, thotë për REL-in se, kur shpërthejnë epidemi, vaksinimi i detyrueshëm është mënyra më efektive për t'i frenuar ato. Por, shumë njerëz, shton ai, e perceptojnë këtë si tejkallim të kompetencave nga ana e qeverisë. "E di që në Shtetet e Bashkuara, njerëzit që vijnë nga Evropa Lindore, ku shoqëritë ndoshta kanë qenë më të shtypura, janë më të shpejtë për të refuzuar çdo gjë që qeveria u thotë të bëjnë", thotë Offit, bashkëzhvillues i vaksinës kundër rotavirusit dhe drejtor i Qendrës për Edukimin mbi Vaksinat në Spitalin e Fëmijëve të Filadelfias.

Ai shton se debati shpesh përplasat mes idesë së "lirisë mjekësore", ku individë vendos vetëm për veten, dhe shëndetit publik, që kërkon përgjegjësi edhe ndaj të tjerëve.

Sipas IKSHPK-së, këto debate kanë çuar në atë që OBSH-ja e quan infodemi, për shkak të përhapjes së informacioneve të pasakta nga "burime joprofesionale që kanë krijuar narrativë të pasaktë".

Së fundi, një kosovar me rreth 150 mijë ndjekës në Facebook postoi se të gjithë ata që nuk janë vaksinuar për Covid-19, duhet të jenë krenarë me veten, që i rezistuan një "propagande prej qindra miliona dollarësh".

Rreth një muaj më parë, Policia e Kosovës arrestoi Arianit Sllamnukun, figurë që gjithashtu kishte krijuar një ndjekje në llogarinë e tij në Facebook, nën dyshimet se ushtronte kundërligjshëm veprimtari mjekësore dhe eksperimente me ilaçe.

Sllamniku, pa ekspertizë

mjekësore, raportohet t'u ketë kërkuar mijëra euro prindërve mbi pretendimin se shëron autizmin të fëmijët.

Autizmi është çrregullim i zhvillimit neurologjik që ndikon në komunikim, ndërveprim social dhe sjellje, duke u shfaqur zakonisht në fëmijërinë e hershme. Për të nuk ka kurë, por ka mbështetje dhe ndërhyrje terapeutike që mund të ndihmojnë në zhvillimin e aftësive.

Frika nga autizmi është përmendur edhe nga nënat që komentuan në postimin e REL-it në Facebook, si arsye pse nuk i vaksinojnë fëmijët e tyre.

Vakcina për të cilën ka më së shumti mosbesim, është ajo që u jepet fëmijëve kur i mbushin 1 vjet, e njohur si MMR. Kjo është një vaksinë e kombinuar që mbron kundër tri sëmundjeve ngjitëse: fruthit, shytave dhe rubeolës.

Kjo mbetet vakcina e vetme për të cilën është shënuar rënie e mbulueshmërisë në Kosovë.

Nga 89 për qind në vitin 2024, përqindja e fëmijëve të vaksinuar zbriti në 82 për qind në vitin 2025.

Vetëm katër nga gjithsej 20 dozat në kalendarin e vaksinimit të fëmijëve në Kosovë kanë arritur të paktën nivelin e mbulueshmërisë prej 95 për qind, që OBSH-ja e përshkruan si nivelin e nevojitur për të parandaluar shpërthimet epidemike.

Rënia e vaksinimit kundër fruthit është përcjellë me rritje të numrit të rasteve të identifikuara me këtë sëmundje.

Në raportin e IKSHPK-së për vitin 2025 thuhet se vendi ndodhet në "një situatë epidemiologjike të ngjashme me atë të rajonit, i cili është përballur me shpërthime epidemike".

Vetëm gjatë muajit janar, IKSHPK-ja raportoi dy raste me fruth, në Prizren dhe në Vushtri, dhe një rast me rubeolë në Prishtinë. Të gjithë fëmijët e infektuar ishin të pavaksinuar.

Latifi diskuton për orarin e kujdestarisë me pronarët e barnatoreve private në Rahovec



RAHOVEC, 26 SHKURT - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka pritur në takim pronarët e barnatoreve private që operojnë në Rahovec, me të cilët ka diskutuar për organizimin e orarit të kujdestarisë, për respektimin rigoroz të orarit të punës, përfshirë edhe të dielave dhe

festave zyrtare, si dhe nevojën për një koordinim më të mirë mes tyre, në mënyrë që shërbimi farmaceutik të jetë i garantuar në çdo kohë për qytetarët tanë. "Kërkova përkushtim më të madh dhe përgjegjësi të shtuar, sepse barnaret janë hallkë e rëndësishme e sistemit

shëndetësor. Qytetarët duhet ta kenë të qartë se ku dhe kur mund të marrin shërbimin e nevojshëm, sidomos në raste urgjente dhe përgjatë natës. Angazhimi ynë i përbashkët është të jemi sa më afër qytetarëve, të qasshëm dhe sa më të organizuar", ka thënë Latifi pas takimit.

BEDRI HAMZA KUJTON ADEM DEMAÇIN DHE BETIMIN E HASHIM THAÇIT SI PRESIDENT: SAKRIFICA U KTHYE NË INSTITUCION, ËNDRRA NË SHTET

PRISHTINË, 26 SHKURT - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Bedri Hamza, ka publikuar një fotografi simbolike në rrjetet sociale, duke e lidhur atë me dy data të rëndësishme për historinë politike të vendit: 90-vjetorin e lindjes së Adem Demaçit dhe dhjetëvjetorin e zgjedhjes së Hashim Thaçit president i Kosovës. “Ua gjeta këtë fotografi si kujtim i dy datave të rëndësishme: 90-vjetorit të lindjes së Adem Demaçit, frymëzimit të brezave të patriotëve që bënë histori në vendin tonë, si dhe dhjetëvjetorit të zgjedhjes së Hashim Thaçi si president”, ka shkruar Hamza. Ai ka rikujtuar simbolikën e betimit të Thaçit në ditëlindjen

e Demaçit. “Në ditëlindjen e tij, para dhjetë vjetësh, një tjetër patriot i madh u betua si President i Kosovës së pavarur, duke kthyer sakrificën në institucion dhe ëndrrën në shtet”, ka thënë Hamza. Sipas Hamzës, figura e Demaçit mbetet e pazëvendësueshme në historinë kombëtare. “Baca Adem mbetet figurë e qëndresës, humanizmit dhe sakrificës për liri, barazi dhe dinjitet njerëzor”, është shprehur ai. Në fund, ai ka theksuar se “edhe sot, vlerat e tij dhe të çdo luftëtari të lirisë mbrohen me dinjitet nga çlirimtarët tanë, në burgun e fundit politik për popullin tonë”, duke e përmbyllur mesazhin me fjalët: “Liri. Drejtësi.”



IKD-JA PADIT MINISTRINË E SHËNDETËSISË, KËRKON SHFUQIZIMIN E TARIFËS 3 EURO PËR SHOQËRUESIT E PACIENTËVE

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 26 SHKURT - Instituti i Kosovës për Drejtësi ka dorëzuar të enjten padi në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës përmes së cilës ka kërkuar shfuqizimin e disa dispozitave të Udhëzimit Administrativ nr. 03/2024 - Bashkëpagesat për shërbimet shëndetësore.

Padia kundërshton specifikisht pikën 4 të Shtojcës 3 dhe pikën 5 të Shtojcës 4 të këtij Udhëzimi Administrativ, të cilat parashohin obligimin për pagesën prej 3 eurosh për çdo ditë qëndrimi në spital për personin shoqërues të pacientit mbi moshën 15 vjeç.

Në padi thuhet se IKD konsideron se këto pika janë të kundërligjshme, pasi që përmes një akti nënligjor është krijuar një kategori e re tarifimi që nuk gjen bazë në Ligjin për Shëndetësi. Sipas këtij ligji, bashkëpagesa lidhet



drejtpërdrejt me shfrytëzimin e një shërbimi shëndetësor nga pacienti. Ndërsa personi shoqërues nuk është përfitues i ndonjë shërbimi mjekësor, nuk i nënshtrohet trajtimit, diagnostikimit apo procedurave klinike dhe për rrjedhojë, nuk mund të konsiderohet “shfrytëzues i shërbimeve shëndetësore” në kuptim të ligjit. Specifikisht, IKD në padi potencon se “në mungesë të një dispozite të qartë në ligj, që e

njej qëndrimin e shoqëruesit si ‘shërbim shëndetësor’, Ministria nuk ka bazë ligjore që ta kualifikojë atë si objekt bashkëpagese përmes një akti nënligjor. Për rrjedhojë, paditësi konsideron se pika 4 e Shtojcës 3 dhe pika 5 e shtojcës 4 e Udhëzimit Administrativ të atakuara me këtë padi, janë të kundërligjshme, sepse formulimi në këto pika tejkalon autorizimin e dhënë nga ligji, duke e zgjeruar konceptin e ‘shërbimit shëndetësor’ përtej

asaj që është përcaktuar shprehimisht nga Ligji për Shëndetësi. Në këtë drejtim, paditësi konsideron se një akt nënligjor nuk mund të krijojë kategori të reja tarifimi që nuk gjejnë bazë në ligjin primar, sidomos kur ato ndikojnë në ushtrimin e të drejtave themelore të qytetarëve. Në këtë rast, mungon edhe baza materiale për ta konsideruar qëndrimin e shoqëruesit si shërbim, gjithashtu edhe lidhja e nevojshme juridike midis tarifës dhe një veprimtarie shëndetësore të ofruar nga institucioni publik ndaj atij personi”. Për më tepër, IKD në padi ka përmendur edhe reagimin publik të Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës (ShSKUK) përmes të cilit ky i fundit ka sqaruar se kjo pagesë nuk aplikohet për pacientin, por lidhet me shfrytëzimin e hapësirave dhe resurseve spitalore nga persona që nuk janë pacientë.

Në këtë kuptim, IKD konsideron se Ministria e Shëndetësisë ka tejkaluar kompetencat, duke zgjeruar përmes aktit nënligjor konceptin e “shërbimit shëndetësor” përtej asaj që është përcaktuar qartë në ligjin primar.

IKD e ka ngritur këtë padi në cilësinë e mbrojtësit të interesave të gjera të publikut, në përputhje me Ligjin për Konfliktet Administrative.

Në padi IKD ka vlerësuar se tarifa prej 3 eurosh në ditë për shoqëruesit cenon të drejtat e qytetarëve dhe krijon barrë financiare shtesë për familjet, sidomos në një sistem shëndetësor ku prania e shoqëruesit shpesh është domosdoshmëri faktike, pasi që, siç thuhet në padi, në praktikën aktuale, qëndrimi i familjarëve përtej orarit të vizitave nuk është zgjedhje e lirë, por nevojë reale për të ofruar mbështetje bazë për pacientët.

Kosova, e para në Ballkanin Perëndimor sa i përket sigurisë, Sveçla: Qëndrueshmëria institucionale ndikoi pozitivisht në rritjen e sigurisë

PRISHTINË, 26 SHKURT - Sipas raportit “SecuriMeter 2025” të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (RCC), Kosova renditet me nivelin më të lartë të perceptimit të sigurisë personale në rajon. 64 % e qytetarëve kanë deklaruar se ndihen “shumë të sigurt” ose “mjaf të sigurt” në jetën e tyre të përditshme, duke shënuar përqindjen më të lartë ndër

gjashtë vendet e rajonit. Kështu ka bërë me dije ministri i Brendshëm, Xhelal Sveçla. Ai ka thënë se ky rikonfirmim i besimit ndaj institucioneve të mbrojtjes dhe sigurisë është tregues i mbështetjes së vazhdueshme të qeverisë ndaj ushtrisë dhe policisë, mbështetje që ka reflektuar në forcimin e kapaciteteve dhe rritjen e

efikasitetit të tyre në shërbim të qytetarëve. “Nga ana tjetër, dëshmon edhe për rritjen e vazhdueshme të besimit dhe sigurisë së qytetarëve kundrejt institucioneve publike përgjatë qeverisjes sonë. Qëndrueshmëria institucionale ka ndikuar pozitivisht në rritjen e sigurisë, luftimin e fenomeneve negative dhe avancimin e progresit demokratik. Si rezultat

i kësaj, 80.5 % e qytetarëve kanë deklaruar që nuk duan të emigrojnë, vlerësim ky i dallueshëm nga vitet paraprake. Përgëzoj zyrtarët e të gjitha institucioneve tona për këtë vlerësim si dhe për përkushtimin dhe profesionalizmin e tyre në shërbim të Republikës dhe të gjithë qytetarëve tanë”, ka shkruar ai në “Facebook”.



Kosova dhe Malta shkëmbejnë përvojat profesionale në auditimin publik

PRISHTINË, 26 SHKURT - Auditorja e Përgjithshme e Republikës së Kosovës, Vlora Spanca, e shoqëruar nga zëvendësauditori i përgjithshëm Beza Halilaj, drejtori i Departamentit të Auditimit, Faruk Rrahmani dhe shefja e kabinetit, Shqipe Çavdarbasha, ka vizituar Zyrën Kombëtare të Auditimit të Maltës dhe është pritur në takim nga auditori i përgjithshëm Charles Deguara me bashkëpunëtorë.

Vizita dyditore pati për qëllim avancimin e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve dhe

shkëmbimin e përvojave profesionale.

Auditorja e përgjithshme Vlora Spanca theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe rolin e institucioneve supreme të auditimit në menaxhimin e financave publike dhe qeverisjes. “Edhe pse vendet tona dallojnë për nga relievi, ne jemi të bashkuar nga një qëllim: t’u shërbejmë qytetarëve tanë me integritet, profesionalizëm dhe pavarësi. Institucionet tona kanë një përgjegjësi jetike në forcimin e llogaridhënies, rritjen e transparencës dhe ndërtimin e

besimit publik. Vlera e vërtetë e punës sonë arrihet kur rekomandimet tona sjellin përmirësime të qëndrueshme dhe konkrete”, deklaroi Spanca. Përfaqësuesit e dy institucioneve mbajtën sesione të përbashkëta pune ku paraqitën praktikën dhe përvojat e tyre mbi auditimin e performancës, leadershipin, organizimin institucional, strategjinë e komunikimit, rishikimin nga kolegët (SIGMA Peer Review 2023) si dhe monitorimin e zbatimit të rekomandimeve.

Auditorët e përgjithshëm nga të



dyja vendet në përmbyllje të vizitës riafirmuan gatishmërinë për vazhdimin e bashkëpunimit dhe shkëmbimin e përvojave

profesionale në funksion të forcimit të rolit dhe ndikimit të auditimit publik në Kosovë dhe Maltë.

RAPORTI I BERZH-it: KOSOVA NDËR VENDET MË TË GODITURA NGA TARIFAT E REJA TË SHBA-së

PRISHTINË, 26 SHKURT - Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) kanë vendosur një paketë të re tarifash prej 10-përqindësh për importet ndaj të gjitha shteteve, e cila ka hyrë në fuqi më 24 shkurt. Sipas një raporti të publikuar më 26 shkurt nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh), Kosova renditet ndër vendet më të goditura nga këto tarifa në rajonin ku operon kjo bankë. Sipas BERZH-it, tarifatat e importit të ShBA-së për vendet e rajonit janë rritur mesatarisht me 0.3 pikë përqindjeje, ndërsa 29 shtete përballen tani me

tarifa më të larta. Rritjet më të mëdha janë regjistruar në Armeni, Egjipt, Kenia, Kosovë dhe Ukrainë. “Rritja e tarifave për Armeninë, Egjiptin, Kenian, Kosovën e Ukrainën lëviz nga +3.7 deri në +4.8 pikë përqindjeje”, është thënë në raport.

Disa vende të tjera të rajonit si Bosnjë-Hercegovina e Serbia, si dhe Moldavia e Tunizia, konsiderohen përfituese relative nga ndryshimet e fundit tarifore pasi tarifatat ndaj tyre ose kanë pasur rritje shumë më të vogël, ose kanë mbetur pothuajse në të njëjtin nivel.



Raporti ka nënvizuar se mesatarisht tarifatat e importit të ShBA-së për vendet ku operon BERZH-i janë rritur nga 14.6 në 15 për qind, duke rritur presionin mbi eksportuesit,

përfshirë edhe ata nga Kosova. Raporti thekson se tarifatat kanë pasur efekt më pak sesa është pritur.

Më 20 shkurt Gjykata Supreme e ShBA-së ka rrëzuar tarifatat globale të Trumpit përveç atyre për industrinë e çelikut, aluminit, drurit dhe automobilave, me argumentin se ligji emergjent për fuqitë ekonomike nuk ia lejon presidentit të vendosë tarifa të tilla. Më pas, presidenti amerikan u zotua për tarifa të reja prej 15-përqindësh, por në fund vendosi ta zëvendësojë tarifën prej 10-përqindësh me

një të re në po atë vlerë - kësaj radhe në bazë të nenit 122 të Aktit të Tregtisë të vitit 1974, i cili i lejon presidentit të vendosë një tarifë të tillë për 150 ditë pa miratimin e Kongresit.

Sipas të dhënave të Doganës së Kosovës, në vitin 2019 ishin eksportuar mallra në ShBA me vlerë tre milionë euro, ndërsa tre vjet më vonë (2022) kjo shifër u rrit në mbi 131 milionë euro.

Produktet që i eksporton Kosova në ShBA përfshijnë ushqime, lëngje, tekstil, dyshekë, por dhe prodhime nga druri dhe plastika.

KOMUNA E KAMENICËS, BASHKËPUNIM TË RI PËR MBËSHTETJEN E GRAVE SIPËRMARRËSE

RAHOVEC, 26 SHKURT - Kryetari i komunës së Kamenicës, Kadri Rahimaj, ka nënshkruar marrëveshje me Fondacionin për Zhvillim të Qëndrueshëm Ekonomik “Preda Plus” për projektin “Her Future” (E ardhmja e saj) Fuqizimi i Grave Sipërmarrëse në Kosovë. Në këtë takim organizata “Her Future” është përfaqësuar nga Valentin Hoxha që është edhe drejtor i këtij projekti dhe nënshkrues i memorandumit.

Në takim kanë marrë pjesë edhe nënkryetarja e komunës së Kamenicës, Arta Bajralija,



drejtori i DZHE-d-së, Edon Dërmaku, si dhe Qendresa Kastrati, zyrtare nga po kjo

drejtori.

Ky projekt financohet nga Ministria për Bashkëpunim

Ekonomik dhe Zhvillim e Gjermanisë.

Projekti synon fuqizimin e grave në Kosovë përmes zhvillimit të aftësive të tyre të biznesit, krijimit të rrjeteve mbështetëse dhe nxitjes së një mjedisi të favorshëm për pjesëmarrjen ekonomike të grave.

Projekti fokusohet në planifikim strategjik, rritje kapacitësh dhe krijimin e hapësirave të dedikuara ku gratë sipërmarrëse mund të lidhen, të mësojnë dhe ta rrisin biznesin e tyre, duke kontribuar kështu në barazi gjinore dhe zhvillim të

qëndrueshëm ekonomik.

Ky projekt ka gjithsej pesë komponentë dhe synon të ketë 562 përfitues, duke përfshirë këtu gratë sipërmarrëse, vajzat e reja si dhe përfaqësues nga institucionet qendrore dhe lokale, shoqëria civile dhe shoqatat e biznesit.

Projekti kap vlerën e 1 333 000 eurosh që do të shpërndahen në formë të 100 granteve për gratë në të gjithë Kosovën.

Komuna e Kamenicës do t'i informojë qytetarët me kohë rreth thirrjes se kur do të hapet si dhe rreth hapave për aplikimin.

Ministrja Kusari-Lila priti në takim përfaqësuesin e AMIK-ut

PRISHTINË, 26 SHKURT - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, Mimoza Kusari-Lila, ka pritur të enjten në takim Shpresim Vranovcin nga Asociacioni i Institucioneve Mikrofinanciare të Kosovës (AMIK).

Gjatë takimit ministrja u njoftuar me veprimtarinë e asociacionit dhe sfidat me të cilat përballen institucionet

mikrofinanciare në vend.

Diskutimet përfshinë edhe gatishmërinë e AMIK-ut për të bashkëpunuar në hartimin e Ligjit për Shoqëritë Tregtare, i cili pritet të implementohet gjatë kësaj legjislatore.

Fuqizimi i grave në biznes u vlerësua si një ndër prioritetet kryesore, duke u theksuar rëndësia e mbështetjes së grave në

ndërmarrësi dhe në zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm.

Ministrja theksoi se bashkëpunimi me sektorin financiar është thelbësor për rritjen e ndërmarrësisë dhe për përmirësimin e klimës së biznesit në Kosovë, duke siguruar mundësi reale për investime dhe zhvillim afatgjatë.



HELENA E TROJËS DHE GËNJESHTRA MIJËRA VJEÇARE

Kur fajin e ka gjithmonë ... gruaja



Të gjithë e dimë historinë. Helena e Trojës, fytyra që nisi një mijë anije. Gruaja më e bukur e botës antike. Gruaja që u rrëmbye. Ose gruaja që u largua me dëshirë. Në varësi të versionit që zgjedh të besosh.

Në njërin rrëfim, perëndesha Afërdita ia premton Helenën Parisit, princit të Trojës. Ka vetëm një problem të vogël: ajo është e martuar me Menelaun, mbretin e Spartës. Parisi e merr me vete dhe... shpërthen lufta. Dhjetë vjet gjak, heroizma, tradhti, qytete të djegura.

Në një tjetër version, më pak i njohur por po aq i fuqishëm, Helena nuk është viktimë. Ajo zgjedh vetë. Dashurohet dhe largohet me vullnet të plotë. Një grua që braktis martesën për një pasion. Por prapë ka luftë...

Dy versione. Dy moralitete të

kundërta. Por një përfundim i vetëm: fajin e ka Helena.

Nëse ajo rrëmbehet, është shkaku i luftës. Nëse ajo zgjedh vetë, është shkaku i luftës. Nëse është viktimë, është shkaku. Nëse është e lirë, është shkaku.

Është një paradoks që përsëritet me një saktësi pothuajse të frikshme: çfarëdo që të bëjë ajo, narrativa gjen mënyrën për ta kthyer në epiqendër të katastrofës. Por le të ndalemi për një moment dhe ta zhveshim mitin nga poezia.

Helena e Trojës dhe lufta që mobilizoi mbretërit

A ishte vërtet Helena ajo që mobilizoi mbretërit e Greqisë? A ishte ajo që ngriti ushtritë,

që mbushi anijet me ushtarë, që ushqueu krenarinë e lënduar të burrave? Apo lufta kishte nevojë për një justifikim?

Në botën e lashtë, nderi i një mbreti ishte çështje pushteti. Aleancat mes mbretërve grekë ishin të brishta dhe të mbështetura mbi betime të përbashkëta. Kur Helena u martua me Menelaun, princat e tjerë u betuan ta mbronin martesën e saj. Jo për dashurinë, por për ekuilibrin politik.

Kur ajo largohet, rrëfimin romantik e mbulon një realitet më i ftohtë: burrat kishin një arsye për të luftuar. Një pretext të përsosur për të afirmuar forcën, për të fituar lavdi, për të zgjeruar ndikimin.

Helena u bë historia që e bënte luftën të dukshme dhe

të pranueshme. Sepse është më e lehtë të thuash “një grua e bukur e nisi gjithë këtë”, sesa të pranosh se luftërat lindin nga ambicia, egoja dhe etja për pushtet. Është më e lehtë të personifikosh një katastrofë në një fytyrë sesa ta shpjegosh me struktura, interesa dhe rivalitete.

Miti nuk është thjesht një tregim i vjetër. Ai është një model mendimi. Helena shndërrohet në simbol të tundimit, të çrregullimit, të shkatërrimit që vjen kur rendi mashkullor tronditet. Ajo është paralajmërim i heshtur: zgjedhja e një gruaje mund të përmbyjë botën.

Por ndoshta e vërteta është më e zhveshur. Luftërat nuk nisin nga dashuria. Ato nisin nga krenaria. Nuk nisin nga bukuria, por nisin nga pushteti.


Helena e Trojës nuk komandoi ushtri

Helena mund të ketë qenë e rrëmbyer. Mund të ketë qenë e dashuruar. Mund të ketë qenë thjesht një figurë e përdorur nga poetët për ta bërë historinë më dramatike. Por një gjë është e qartë: ajo nuk komandoi ushtri, nuk shpalli betejë, nuk ndërtoi kalin prej druri.

Megjithatë, për mijëra vjet, ne vazhdojmë ta përsërisim formulën: “lufta e Trojës nisi për shkak të Helenës”.

Ndoshta sepse është një fjali e bukur. Ose ndoshta sepse na bën të ndihemi më rehat. Sepse nëse fajin e ka Helena, atëherë burrat që dogjën qytetin janë thjesht reagimi. Ja, këtë të bëjnë mitet. / bota.al





Ademi uron Infantinon për 10-vjetorin në krye të FIFA-s

PRISHTINË, 26 SHKURT - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, ka uruar presidentin e FIFA-s, Gianni

Infantino, për 10-vjetorin në krye të qeverisjes së futbollit botëror. Ademi ka thënë se kjo dekadë nën leadershipin e presidentit Infantino ka

shënuar transformim të thellë në zhvillimin e lojës më të dashur në botë. "Gjatë kësaj periudhe FIFA ka mbështetur fuqishëm futbollin e Kosovës

në avancimin e projekteve infrastrukturore, programeve zhvillimore dhe fuqizimin e strukturave të FFK-së", ka thënë presidenti Ademi.

"DARDANET" NISIN PËRGATITJET PËR CIKLIN KUALIFIKUES TË KUPËS SË BOTËS 2027

DRENAS, 26 SHKURT - Kombëtarja e Kosovës në konkurrencën e femrave e ka zhvilluar sot seancën e parë stërvitore në stadiumin "Rexhep Rexhepi" në Drenas, në kuadër të përgatitjeve për dy ndeshjet e para të ciklit të ri kualifikues për Kupën e Botës 2027. Kosova garon në Ligën C, në një grup sfidues së bashku me Kroacinë, Bullgarinë dhe Gjibraltarin. Ndeshjen e parë "Dardanet" do ta zhvillojnë më 3 mars në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë, ku do të përballen me Gjibraltarin. Përzgjedhësi Sami Sermahaj ka theksuar se objektivi kryesor mbetet kalimi në Ligën B. "Edhe pse cikli kualifikues është i ri, objektivat mbeten të njëjta si ato të vitit të kaluar. Siç dihet, edicionin e kaluar nuk arritëm të kualifikohemi drejtpërdrejt dhe na u desh ta kërkojmë

kualifikimin përmes fazës së 'play-off'-it. Aty u përballëm me një kundërshtar më të fortë dhe, fatkeqësisht, nuk arritëm ta sigurojmë promovimin në Ligën B. Këtë vit synimi mbetet i pandryshuar. Objektivi është i qartë, kalimi në Ligën B. Edhe pse kemi një grup sfidues, ku Kroacia konsiderohet favorite kryesore, besoj se grupi i lojtareve të jetë më i harmonizuar. Kosova ka në radhët e veta lojtare me personalitet që do të ndihmojnë në kualifikim në Ligën B. Jo vetëm ndaj Kroacisë, por edhe ndaj kundërshtarëve të tjerë në grup, do të kërkojmë formulën e duhur për ta arritur objektivin tonë", ka thënë Sermahaj. Edhe futbollistet e Kombëtares kanë shprehur optimizëm para fillimit të këtij cikli. Blerta Ismaili ka thënë se atmosfera në Kombëtaren e Kosovës



është pozitive. "Objektivi është të shkojmë në Ligën B. Do të fokusohemi në lojën e parë kundër Gjibraltarit dhe presim ta nisim me fitore", ka thënë ajo. Ndërsa Donjeta Halilaj ka theksuar rëndësinë e formës dhe përkushtimit të ekipit: "Për momentin të gjitha vajzat vijnë nga kampionatet aktive dhe janë në formën e duhur. Synimi

ynë kryesor është të kalojmë nga Liga C në Ligën B. Gjithmonë e kemi pasur këtë synim, por nganjëherë nuk është fati me ne. Mendoj se tani janë mundësitë e mëdha. Besoj se me fokus e punë të gjitha arrihen. Në ekipin tonë ka edhe vajza të reja dhe besoj se do të kombinohen shumë mirë. Në ndeshje nuk ka favoritë, në lojë duhet të

hyjmë me synim maksimal. Kundër Gjibraltarit është ndeshja e parë e grupit dhe duhet ta fitojmë, pastaj të mendojmë për ndeshjen tjetër", ka thënë Halilaj. "Dardanet" do t'i vazhdojnë përgatitjet në ditët në vijim, me synimin për ta nisur mbarë këtë cikël të ri kualifikues dhe për ta bërë hapin e madh drejt promovimit në Ligën B.



KOSOVA ME DY XHUDISTE NË UZBEKISTAN

PRISHTINË, 26 SHKURT - Kosova do të paraqitet me dy xhudiste në Grand Slamin në Tashkent të Uzbekistanit. Erza Muminoviq do të garojë në kategorinë deri 48 kilogramë, ndërsa Flaka Loxha në kategorinë deri 57

kilogramë. Të dy xhudistet garojnë sot (e premte), në ditën e parë të këtij Grand Slami. Trajneri i Kosovës në xhudo, Driton Kuka, ka vendosur të pushojë nga kjo garë adutët kryesorë, Distria Krasniqin, Laura Fazliun dhe Akil

Gjakovën. Ndërkohë për Loxhën e Muminoviqin, kjo do të jetë garë e rëndësishme, pasi asnjëra nuk është bartëse dhe kërkojnë medaljen e parë në Grand Slam. Në Uzbekistan garojnë 370 xhudistë nga 39 vende të ndryshme.

Hamdi Namani mbyll sezonin pas dëmtimit në ndeshjen Gjilani - Prishtina

GJILAN, 26 SHKURT - SC Gjilani ka marrë një lajm të hidhur pas ndeshjes ndaj FC Prishtinës, pasi futbollisti Hamdi Namani ka pësuar një dëmtim të rëndë që e detyron ta mbyllë sezonin. Klubi ka njoftuar zyrtarisht se Namani është lënduar në regionin e gjurit gjatë përballjes së

fundit. Pas kontrolleve dhe ekzaminimeve mjekësore të kryera, është konfirmuar se ai ka pësuar rakturë të ligamentit medial kolateral (MCL), një dëmtim serioz që kërkon kohë të gjatë rehabilitimi. Si pasojë e kësaj lëndimi, lojtari do t'i nënshtrohet trajtimit dhe

procesit të rikuperimit sipas protokollit mjekësor, ndërsa sezoni aktual konsiderohet i mbyllur për të. Nga klubi është bërë me dije se Namani do ta ketë mbështetjen maksimale gjatë gjithë fazës së rehabilitimit, teksa i ka uruar shërim të shpejtë dhe rikthim në fushën e blertë.

"Klubi do të vazhdojë ta mbështesë Namanin maksimalisht gjatë procesit të rehabilitimit, njëherësh i urojmë shërim sa më të shpejtë", është thënë në njoftimin e SC Gjilani. Hamdi Namani është në huazim nga Prishtina te Gjilani deri në fund të sezonit.





ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

